



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°22/2022

Hagë, 09/06/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 26 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi dhe z. Veseli.

Në të dy rastet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekziston ende rreziku që të akuzuarit mund të arratisen dhe të ushtrojnë ndikimin e tyre në Kosovë për të kërkuar mbështetjen e ish-vartësve, të cilët mund të jenë të gatshëm t'u sigurojnë fonde dhe mjete për të udhëtuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej vlerësoi se ekziston ende rreziku që të akuzuarit mund të pengojnë procesin gjyqësor dhe të kryejnë krime të tjera për shkak të atmosferës së vazhdueshme të frikësimit dhe ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në Kosovë.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit gjyqësor dhe kryerjes së krimeve të tjera nuk mund të zvogëlohet mjaftueshëm nga asnjë masë shtesë jashtë objektivit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Më 1 qershor 2022, në çështjen gjyqësore kundër z. Salih Mustafa, Trupi Gjykses caktoi një ekspert financiar që të përlllogarisë dëmet materiale dhe humbjet ekonomike që kanë pësuar viktimat e pretenduara në këtë çështje gjyqësore. Pritet që eksperti financiar ta dorëzojë raportin brenda 23 qershorit 2022.

Gjithashtu, më 3 qershor 2022 Trupi Gjykses pranoi si prova dy aktekspertiza, të cilat përmbajnë vlerësim mjekoligjor, psikologjik dhe fiziologjik të dëmeve dhe lëndimeve që kanë pësuar viktimat.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°22/2022

Hagë, 09/06/2022

Trupi Gjykes nxori edhe urdhra me të cilët përcaktoi afatet për ZPS-në që të paraqesë kundërprova shtesë, nëse dëshiron, si dhe për Mbrojtjen që të dorëzojë kërkesën për paraqitjen e provave kundërpërgjigjëse.

Të gjitha parashtrimet publike të protokolluara gjenden në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

